

UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORI

Nr. 309 prot.

Tiranë, 09.03.2020.

URDHËR

Nr. 26, datë 09.03.2020

PËR

NDËRPRERJEN E PROCESIT MËSIMOR PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES  
SË COVID - 19

Drejtuar: FAKULTETIT TË MUZIKËS  
FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA  
FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK

Për dijëni: Administratorit të UART  
Drejtorisë Ekonomike dhe Investimeve  
Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Mbështetur në Urdhrin 135, dt.09.03.2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për mbylljen e Institucioneve Arsimore për parandalimin e përhapjes së COVID-19, dhe Urdhrit Nr. 91, dt. 09.03.2020 të Ministrisë Arsimit, Rinisë dhe Sporteve "Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike", dhe në mbështetje të Ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", Neni 7 "Në masa të veçanta", pika 4 "Për të mbrojtur popullatën nga sëmundjet infektive që kanë impakt në shëndetin e saj, ministri përgjegjës për shëndetësinë miraton, me urdhër, masa të veçanta për mbrojtjen nga këto sëmundje, sipas udhëzimeve kombëtare, të përgatitura nga Instituti i Shëndetit Publik" gërma a) "mbyllja e shkollave", Urdhëroj:

Ndërprerjen e procesit mësimor dhe aktiviteteve artistike në Universitetin e Arteve për një periudhë 2 (dy) javore, deri më 23 mars 2020

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Prof. Kastriot CAUSHI